



# ZËRI I FUQISHËM I KOMUNITETIT: MBËSHTETUR NË INFORMACIONIN MJEDISOR

*Udhëzues për organizatat e shoqërisë civile në Shqipëri për përdorimin e informacionit në Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve*

Përgatitja e këtij materiali u mbështet nga projekti "*Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Western Balkan Countries and the Republic of Moldova*", i cili u financua nga Ministria Federale Gjermane e Mjedisit me fonde nga Programi i Asistencës Këshillimore (AAP) për mbrojtjen e mjedisit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, Kaukazit dhe Azisë Qendrore si dhe vende të tjera në kufi me Bashkimin Evropian. Ai u mbikëqyr nga Agjencia Gjermane e Mjedisit (UBA) dhe u zbatua nga Participatio Ltd. në partneritet me EcoContact, REC Shqipëri, REC BiH dhe REC Mali i Zi.

Kontribuan në përgatitjen e materialit:

Enkeleda Shkurta

Rodion Gjoka



(c) Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri, 2024

Materiale dhe pjesë të botimit mund të përdoren duke cituar burimin nga janë marrë

## Përmbajtje

1.	Hyrje .....	5
2.	Protokolli për Rregjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve .....	6
3.	Operatorët dhe procesi i raportimit në RSHTN .....	11
4.	Informacioni mjedisor në RSHTN .....	14
5.	Shoqëria civile dhe qasja në informacionin mjedisor të RSHTN .....	17
6.	Advokimi mjedisor kundër ndotjes dhe veprimi komunitar .....	25

## Shkurtime

<b>AKM</b>	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
<b>E-RSHTN</b>	Rregullorja Evropiane për Shkarkimin dhe Transferimin e Ndotësve
<b>EU/BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>IED</b>	Direktiva e Emetimeve Industriale
<b>HCFCs</b>	bonet hidroklorofluorokarbonet
<b>KE</b>	Komisioni Evropian
<b>MTM</b>	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
<b>LCP/IMD</b>	Impiantet e Mëdha me Djegie
<b>NMVOCs</b>	Përbërjet Organike të Paqëndrueshme jo-Metan,
<b>PAHs</b>	Hidrokarburet aromatike policiklike
<b>PM10</b>	Grimcat e pluhurit deri në 10 mikron
<b>POP/NOQ</b>	Ndotës Organikë të Qëndrueshëm
<b>RSHTN</b>	Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve
<b>TOC</b>	Karboni Organik Total
<b>PFCs</b>	Perfluorokarbonet
<b>UNECE</b>	Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## 1. Hyrje

Kjo broshurë informative synon të japë informacion të përmbledhur rreth mundësisë për të marrë informacion rreth ndotjes së mjedisit, të raportuar prej operatorëve industrialë që kanë detyrimin të raportojnë ndotjen që shkaktojnë bazuar në kërkesat e lejes mjedisore dhe përmbushjes së detyrimit për raportim që rrjedh prej Protokollit të Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN), në kuadër të Konventës së Aarhusit.

Ky informacion është i vlefshëm veçanërisht për organizatat e shoqërisë civile dhe komunitetet që janë aktivë për çështjet mjedisore dhe indihmon ata të ndërmarrin veprime advokuese lidhur me ruajtjen e cilësisë së mjedisit. Në mënyrë të vazhduar grupet e komunitetit ngrenë shqetësimin për mosrespektimin e normave të shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë prej aktiviteteve të ndryshme pranë zonave të banuara apo ato të mbrojtura. Rritja e shkallës së transparencës mbi ndikimin mjedisor të këtyre aktiviteteve, përmes të dhënave të publikuara sikundërse edhe të dhënat e RSHTN, ndihmojë monitorimin, dialogun dhe veprimin komunitar për të forcuar zbatimin e kuadrit ligjor mjedisor për një mjedis të shëndetshëm dhe cilësor.

Kjo broshurë sjell edhe përvoja të organizatave mjedisore në Shqipëri dhe rajon, të cilat duke përdorur këto burime informacioni mjedisor kanë mundur të sjellin ndryshimin për komunitetet që përfaqësojnë.

## 2. Protokoli për Rregjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve

Protokoli I RSHTN-së është **instrumenti i parë ligjor** ndërkombëtar detyruar për regjistrat e shkarkimeve dhe të transferimit të ndotësve. **Objektivi** i tij është të rrisë aksesin e publikut në informacione përmes krijimit të regjistrave koherente të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë si dhe të transferimit të tyre jashtë territorit të zhvillimit të aktivitetit ose jashtë territorit të Shqipërisë.

Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve ofrojnë një mekanizëm të rëndësishëm për rritjen e përgjegjshmërisë së përbashkët në lidhje me qëndrimin ndaj mjedisit, për të rritur llogaridhënien e operatorëve ekonomikë (industrialë) që shkarkojnë në mjedis, për të reduktuar ndotjen dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve (RSHTN) si një mjet (mekanizëm) me kosto efektive, merr vlera për nxitjen rreth përmirësimit të performancës mjedisore, për ofrimin e aksesit publik në informacionin mbi ndotësit e shkarkuar dhe të transferuar në komunitete, dhe për përdorim nga qeveritë në ndjekjen e tendencave duke demonstruar:

- progres në zvogëlimin e ndotjes,
- monitorimi i pajtueshmërisë me disa marrëveshje ndërkombëtare,
- përcaktimin e prioriteteve, dhe
- vlerësimin e progresit të arritur përmes politikave dhe programeve mjedisore.

**Koncepti i "shkarkimeve"** në përgjithësi kuptohet për të mbuluar situatat ku ndotësit shkarkohen ose futen në mjedis nga një operator (subjekt ekonomik) ose burime të tjera.

**Koncepti i "transferimeve"** zbatohet për lëvizjen e ndotësve brenda ose ndërmjet operatorëve. Protokoli mbulon vetëm transferimet "jashtë lokacionit përkatës". Lëvizjet e ndotësve ose mbetjeve ndërmjet dy instalimeve të të njëjtit operator në të njëjtin vend ose zona fqinje konsiderohen si një transferim në vend dhe nuk janë subjekt i raportimit sipas Protokollit.

## Burime të rëndësishme informacioni

**Protokolli i RSHTN dhe Portali European i Shkarkimeve Industriale:**

<https://industry.eea.europa.eu/>

**Faqja e Internetit të Protokollit PRTR:**

<https://unece.org/env/pp/protocol-on-prtrs-introduction>

**Udhëzuesi i thjeshtëzuar i Protokollit PRTR:**

<https://unece.org/environment-policy/publications/simplified-guide-protocol-pollutant-release-and-transfer-registers>

**Portali Global i PRTR:**

<https://prtr.unece.org/>

**Faqja e Internetit të Konventës së Aarhusit:**

<https://unece.org/environmental-policy-1/public-participation>

### 2.1 Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve në Shqipëri


Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve në Shqipëri është një bazë të dhënash elektronike publike, për të lehtësuar pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore, me qëllim parandalimin dhe uljen e ndotjes së mjedisit.

Konkretisht, Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve në Shqipëri mundëson që publiku të ketë qasje në informacionin mjedisor në lidhje me sasinë vjetore të shkarkimeve (emetimeve) të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë si dhe të transferimeve të mbetjeve dhe të ndotësve jashtë objektit (off-site) në Ujërat e Ndotura Urbane në kuadër të fushëveprimit të VKM-së Nr. 742 datë 09.09.2015 (<http://akm.gov.al/assets/vkm-nr.742-date-09.09.2015-rshtn.pdf>), e cila ka

transpozuar pjesërisht Rregulloren e KE-së Nr. 166/2006 mbi Regjistrin Evropian të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve amenduar me Rregulloren e KE-së Nr.596/2009.

Ky Regjistër kontribuon në transparencën dhe pjesëmarrjen më efektive të publikut në vendimmarrje mjedisore, pasi përmes internetit, publiku mund të kenë qasje në informacion mjedisor në lidhje me fushëveprimin e VKM-së Nr.742, datë 09.09.2016 dhe Rregullores së KE-së Nr. 166/2006 amenduar me Rregulloren e KE-së Nr.596/2009. Të gjitha objektet e përfshira në Regjistër janë paraqitur në hartën e Shqipërisë, kështu që publiku mund të marrë informacion në lidhje me vendndodhjen dhe adresën e subjektit, aktivitetet e kryera, aktivitetet ekonomike, llojin e shkarkimeve, sasitë e tyre, etj.

Në nivel të Bashkimit Evropian, Regjistri Evropian i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (RESHTN) zbaton dispozitat e Protokollit të PRTR-it miratuar në mbështetje të Konventës së Aarhusit të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje dhe aksesin në fushën e drejtësisë për çështjet mjedisore. Faqja përkatëse online e Bashkimit Evropian (E-PRTR) përfshin gjithashtu të dhëna të raportuara nga 30.000 objekte industriale, të cilat mbulojnë 65 veprimtari ekonomike në të gjithë Evropën.



**Figura 1:** Pamje e faqes së internetit ku shfaqen operatorët në kuadër të RSHTN



## 2.2 Kuadri ligjor shqiptar për RSHTN

Shqipëria aderon në Protokollin UNECE për Regjistrat e Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve dhe ka një detyrim për ta zbatuar atë që me 16 Qershor 2009. Kjo bazohet në Ligjin nr. 9548, datë 01.06.2006, "Për Aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin për Regjistrat e Shkarkimit dhe të Transferimit të Ndotësve";

Bazuar në Nenin 32 "Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve" të Ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar, përcaktohet që RSHTN administrohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit ndërkohë, operatori i veprimtarive, të cilave u referohet ky nen, mban, përditëson dhe i raporton çdo vit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për zbatimin e këtij neni.

VKM nr. 742, "Për funksionimin dhe menaxhimin e regjistrit të shkarkimit e të transferimit të ndotësve, miratimin e listës së veprimtarive dhe të ndotësve, që janë subjekt i këtij regjistri, si dhe të formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve nga operatori", miratuar nga Këshilli i Ministrave më datë 09.09.2015, përcakton detajet që lidhen me kërkesat për vënien në punë dhe menaxhimin e Regjistrit të Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve, listën e veprimtarive dhe atë të ndotësve që përbëjnë objekt të këtij regjistri, si dhe formularin për vetë-deklarimin e të dhënave rreth shkarkimit dhe transferimit të ndotësve nga operatorët përgjegjës. Kjo VKM transpozon pjesërisht Rregulloren nr. EC/166/2006 të KE-së "Për RESHTN-në", ndryshuar përmes Rregullores nr. EC/596/2009 të KE-së, dhe në fuqi që nga data 01.06.2016.

Operatori i impiantit që ka detyrimin për të raportuar, përgatit raportin për vitin kalendarik dhe e dërgon atë pranë AKM-së, brenda datës 1 prill të vitit pasardhës. Ai mban përgjegjësi për vërtetësinë dhe cilësinë e informacionit dhe të dhënave të raportuara.

Në këtë kontekst, AKM-ja analizon dhe verifikon cilësinë e të dhënave të paraqitura nga operatori i impiantit, duke shqyrtuar nëse ato janë të plota, të vazhdueshme dhe të besueshme, si dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare, brenda 90 ditëve nga data e raportimit nga operatori, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Portali i Shkarkimeve Industriale mbulon mbi 60,000 site, në të cilat ushtrohen 65 tipologji të ndryshme veprimtarish ekonomike, të ndara në 9 sektorë.

Në portal shfaqen vendndodhjet e këtyre siteve, të dhënat administrative përkatëse, së bashku me me sasi të lëndëve të rregulluara që janë shkarkuar në ajër, ujë dhe tokë, si dhe transferimin e mbetjeve. Për impiantet e mëdha të djegies (IMD),

disponohen të dhëna shtesë që lidhen me sasinë e energjisë së konsumuar dhe të shkarkimeve.

I miratuar Ligji nr. 10448, i datës 14.07.2011, "Për lejet e mjedisit", ndryshuar në kuadër të transpozimit të IPPC-ve dhe IMD-ve, përmban ndryshime që kanë hyrë në fuqi në janar 2013.

### 2.3 Autoritetet përgjegjëse për RSHTN

Në Shqipëri, autoritetet kombëtare për zbatimin e VKM-së së RSHTN-së janë Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit si pika kontakti në këtë protokoll.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) krijon, mban dhe publikon RSHTN-në, duke i paraqitur të dhënat, si në formë të agreguar, ashtu edhe në formë jo të agreguar, në mënyrë që shkarkimet dhe transferimet e ndotësve të mund të kërkohen dhe të identifikohen, sipas:

- a) shërbimit, duke përfshirë kompaninë mëmë të impiantit, në rastet kur është e zbatueshme, si dhe vendndodhjen e tij gjeografike, përfshirë këtu edhe basenin e lumit;
- b) veprimtarisë;
- c) ndotësit ose mbetjeve, sipas rastit;
- d) ç) përbërësit mjedisorë (ajër, ujë, tokë), në të cilët ndotësi është shkarkuar;
- e) transferimeve të mbetjeve jashtë territorit të impiantit dhe të destinacionit të tyre, sipas rastit;
- f) dh) transferimeve të ndotësve në ujëra të ndotura jashtë territorit të impiantit;
- g) burimeve të shpërndara të ndotësve;
- h) ë) pronarit ose operatorit të impiantit.

### 3. Operatorët dhe procesi i raportimit në RSHTN

Bazuar në Shtojcën 1 –“Aktivitetet” të VKM nr. 742/2015 në Shqipëri duhet të raportojnë në varësi të kapacitetit prodhues dhe jo në varësi të numrit të punonjësve. Kategoritë e **65 aktivitetet** e grupuara në **9 sektorë** (më shumë se Direktiva e IPPC – së) paraqiten në vijim:

1. **Sektori i energjisë** – p.sh. stacionet e energjisë termike apo instalimet e tjera të djegies
2. **Prodhimi dhe përpunimi i metaleve** – p.sh. uzinat e shkrirjes së hekurit
3. **Industria minerare** – p.sh. minierat, furrat e gëlqeres
4. **Industria kimike** – p.sh. prodhimi i kimikateve inorganike apo organike
5. **Menaxhimi i mbetjeve dhe ujërave të zeza** – p.sh. vend-depozitimet, Impiantet e trajtimit të ujit të ndotur urban
6. **Prodhimi dhe përpunimi i drurit/ letrës** – p.sh. uzinat industriale për prodhimin e celulozës
7. **Prodhimi intensiv i gjësë së gjallë dhe bujqësia** – p.sh. instalimet për kultivimin intensiv të shpendëve dhe derrave
8. **Sektori i prodhimeve vegjetative apo nga kafshët për ushqim dhe pirje** – p.sh. trajtimi dhe përpunimi i qumështit
9. **Aktivitete të tjera** – p.sh. impiante për përpunimin e gëzofit dhe lëkurës, lyerja e anijeve, etj.

#### *Kujt i raportohet dhe cilat janë afatet kohore?*

Protokolli kërkon që çdo vend palë të krijojë një sistem kombëtar publik PRTR, i cili:

- mbulon shkarkimet dhe transferimet e ndotësve nga fabrikat (burimet pikësore), të cilat punojnë në të paktën 1 aktivitet të listuar në Shtojcën 1
- transferimi nënkupton transferimin e shkarkimeve ujore të destinuara për t'u trajtuar jashtë impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura dhe transferimi i mbetjeve për trajtim të mëtejshëm
- **përfshin 86 ndotës** (Shtojca II), si gazrat serë, ndotësit e shiut acid, substancat ozon-holluese, metalet e rënda, substancat që mbulojnë nga Konventa e NOQ-ve (Ndotësve organik të qëndrueshëm) dhe disa elemente kancerogjenë si dioksinat.
- **mund të kërkohet për burim pikësor** nga fabrika, vendndodhja, aktiviteti, pronari apo operatori, ndotësit apo mbetjet, si të jetë më e përshtatshme (ajër, ujë, tokë)

Protokolli kërkon që në çdo vend palë të krijojë një PRTR , i cili

- përfshin të dhëna të disponueshme për shkarkimet nga burime të shpërndara (p.sh. transporti dhe bujqësia);
- është bazuar në **raportime detyruese**
- është **publikisht i gjatshëm përmes mjeteve elektronike** (p.sh. interneti) pa pagesë, apo në mënyra të tjera përmes kërkesës (Neni 11 e drejta e publikut për informacion)
- është i thjeshtë në përdorim për nga struktura e tij dhe siguron lidhje me regjistrat e tjerë të linjës

Agjencia Kombëtare e Mjedisit i kërkon pronarit apo punonjësit të një fabrike të caktuar (Shtojca I) të raportojë tek autoritetet përgjegjëse:

- çdo shkarkim të një ndotësi sipas ndotësit dhe kufirit specifik mesatar të përcaktuar në Shtojcën II;
- cdo transferim të një ndotësi në shkarkimet ujore të destinuara për t'u trajtuar jashtë impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura në sasi të përtej kufirit të përcaktuar në Shtojcën II;

*"Fabrikë" nënkupton një apo më shumë aktivitete në të njëjtën zonë, ose në zona të përbashkëta, të cilat zotërohen apo menaxhohen nga i njëjti person fizik apo juridik.*

Raportimi nga operatori duhet të bëhet brenda datës 1 prill të çdo viti për vitin që ka kaluar. AKM-ja analizon dhe verifikon cilësinë e të dhënave të paraqitura nga operatori i instalimit, nëse janë të plota, të vazhdueshme dhe të besueshme, dhe i publikon ato në faqen e saj zyrtare të internetit, brenda 90 ditëve nga data e raportimit nga operatori, si pjesë të Sistemit të Informacionit Mjedisor, sipas përcaktimit në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.


### ***Për çfarë duhet të raportojnë operatorët?***

Operatori i instalimit, përgatit raportin për AKM-në, sipas modelit të përcaktuar në Shtojcën 3, të VKM nr. 742/2015 për një vit kalendarik dhe e dërgon pranë AKM-së, brenda datës 1 prill të vitit pasardhës.

Operatori i instalimit mban të dhënat që shërbejnë për raportimin për shkarkimet dhe transferimet e ndotësve apo mbetjeve jashtë territorit të instalimit për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga viti i fundit kur është bërë raportimi. Në këto të dhëna përfshihet edhe metodologjia e përdorur për grumbullimin e tyre.

Operatorët duhet të raportojnë të gjitha shkarkimet e qëllimshme, aksidentale, rutinë dhe jo-rutinë, ku shkarkimet aksidentale duhet të raportohen më vete. Raportimet duhet të jenë sipas Metodologjive të miratuara ndërkombëtarisht, aty ku janë të disponueshme si:

- o **M – Matja** “Zakonisht disponohen metodologji standarde – standardet CEN dhe ISO”
- o **C – Llogaritja** “Metodologjitë e llogaritjes të miratuara ndërkombëtarisht”
- o **E – Vlerësimi** “supozimi më i mirë, gjykimi i ekspertit (veçanërisht i rëndësishëm në rast aksidentesh)”



*Figura 2: Skemë e raportimit nga operatorët në kuadër të RSHTN*

#### 4. Informacioni mjedisor në RSHTN

Protokolli parashikon qasjen elektronike të drejtpërdrejtë përmes rrjeteve publike të telekomunikacionit, siç është një faqe e hapur në internet, si mjeti kryesor i qasjes në informata për publikun. Në këtë rast, RSHTN duhet të jetë i qasshëm pa pagesë. Kjo formë qasjes në të dhëna ka shumë përparësi.

RSHTN mund të qaset nga kushdo që ka aftësi për përdorimin e kompjuterit në çdo kohë dhe nga çdo vend dhe që ka një lidhje të mirë interneti në dispozicion. Mjetet elektronike mund të përdoren për të kërkuar dhe analizuar të dhënat.

Në Shqipëri, qasja e drejtpërdrejtë në të dhënat e RSHTN ofrohet përmes portalit <http://prtr.akm.gov.al/main/welcome.jsf> që menaxhohet dhe mirëmbahet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

Megjithatë, Protokolli pranon se jo të gjithë kanë qasje të lehtë në internet, dhe për këtë arsye kërkon që palët të ofrojnë "mjete të tjera efektive" për grupet e publikut që nuk kanë qasje të drejtpërdrejtë elektronike në RSHTN. Kjo mund të përfshijë ofrimin e qasjes elektronike në RSHTN në vende publike si bibliotekat ose zyrat e autoriteteve publike, ose ofrimin e kopjeve të të dhënave në formë letre ose CD-ROM. Kur kopjet e të dhënave të RSHTN-së ofrohen sipas kërkesës, Protokolli kërkon që kjo të bëhet brenda një muaji nga data kur është parashtruar kërkesa. Autoriteti kompetent mund të vendosë një tarifë për riprodhimin dhe postimin e informacionit, me kusht që kjo të mos kalojë një shumë të arsyeshme.

#### A janë të gjitha informacionet e hapura për publikun?

Protokolli përcakton rrethana të kufizuara në të cilat një autoritet kompetent mund të mbajë konfidenciale të dhënat e RSHTN-së, p.sh., kur zbulimi publik do të ndikonte negativisht në marrëdhëniet ndërkombëtare, mbrojtjen kombëtare, sigurinë publike ose konfidencialitetin tregtar. Në raste të tilla, arsyet për konfidencialitetin duhet të interpretohen "në mënyrë të kufizuar", duke marrë parasysh interesin e publikut të cilit i ofrohet informacioni i zbuluar dhe nëse informacioni lidhet me shkarkimet në mjedis. Kur informacioni është mbajtur në fshehtësi, regjistri duhet të tregojë llojin e informacionit që është mbajtur në fshehtësi dhe arsyen(et).

### *Cfarë informacioni është i hapur për publikun dhe në cilat faqe të internetit?*

Për publikun është i hapur i gjithë informacioni ku nga operatorët nuk kërkohet të zbatohet ligji i konfidencialitetit, duke filluar që nga emri i kompanisë, NIPT-i, vendndodhja (koordinatat gjeografike), sasia e produktit përfundimtar të prodhuar, shkarkimet totale në tokë, ajër dhe ujë, në kg apo në ton, sipas Shtojcës 2 dhe kufirit të lejuar për raportim, baseni më i afërt ujqor në të cilin shkarkon, transferimet e mbetjeve jashtë territorit të aktivitetit, ose edhe jashtë Shqipërisë për mbetje të rrezikshme apo të parrezikshme etj.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), është duke zhvilluar një sistem dixhital të integruar për fushën e mjedisit. Në këtë kontekst, pjesë e sistemit të ri që lidhet me informacionin mjedisor do të jetë edhe zhvillimi i RSHTN-së. Të gjithë operatorët janë të detyruar të raportojnë online, atëherë kur sistemi është funksional dhe ua mundëson këtë operacion.

**Search by facilities**

2016

Type facility name

Type company name

All river basins

Type city

Type sector code

All economic activities

3 (3) - Cement clinker in rotary

Search

**Search PRTR**

- Search by facilities
- Search by pollutants
- Search by activity

**Search results**

National ID	Facility name	Company	Street	No	ZIP	City
AL01	ANTEA Cement S.R.A.	TITAN Group	Bika e Krujë	PH-0572-07-2010	PO BOX 1746	Fushë-Krujë

**Facility** Releases to air | Releases to land | Releases to water | Waste water transfers | Waste transfers | Energy consumption | Resource consumption | Activities

Facility	ANTEA Cement S.R.A.	River basin district code	Albania	Product name	cement
Reporting year	2016	NACE activity code	Manufacture of cement	Production units	3
Current state		Number of operating hours in year	4755	Production volume	650,000.00
Contact user name	Bleta Pepa	Number of employees	195	Nuts region ID	AD1
Website URI ID	http://www.anteacement.com/?lang=sq	Number of installations	1		

**Facility history** Activity description | Public information | Remark

**Figura 3:** Të dhënat e raportuara nga operatorët të hapura për publikun

### Si mundet të merret informacion rreth raportimit PRTR?

Publiku mund të marrë informacion rreth shkarkimit të ndotjes në një zonë të caktuar përmes faqeve zyrtare ku publikohen këto të dhëna.




Figura 4: Rrjedha e të dhënave për RSHTN


Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka ngritur sistemin e raportimit të RSHTN-së në faqen e internetit të saj. Publiki mund ta aksesojë nëpërmjet linkut: <http://prtr.akm.gov.al/main/welcome.jsf>



Figura 5: Faqja e internetit për AKM për RSHTN



## 5. Shoqëria civile dhe qasja në informacionin mjedisor të RSHTN



Burimi: *European Industrial Emissions Portal*

RSHTN synon të rrisë transparencën dhe të nxisë pjesëmarrje më të lartë të publikut në çështje apo vendimmarrje mjedisore me qëllim parandalimin, kontrollin apo edhe reduktimin e ndotjes në mjedis. Ky regjistër është një bazë të dhënash elektronike dhe publike, ku qasja në lidhje me informacionin mjedisor sa i takon shkarkimeve vjetore të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë si dhe të transferimeve të mbetjeve dhe të ndotësve. Të gjitha objektet e përfshira në Regjistër janë paraqitur në hartën e Shqipërisë, kështu që publiku mund të marrë informacion në lidhje me vendndodhjen dhe adresën e subjektit, aktivitetet e kryera, aktivitetet ekonomike, llojin e shkarkimeve, sasite e tyre, etj.

Në nivel të Bashkimit Evropian, Regjistri Evropian i Shkarkimeve dhe Transferimit të Ndotësve (E-PRTR) zbaton dispozitat e Protokollit të PRTR-it miratuar në mbështetje të Konventës së Aarhusit të Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) për aksesin në informacion, pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe aksesin në fushën e drejtësisë për çështjet mjedisore.

Në kuadër të kërkesave prej integritit evropian të vendit, rregullorja E-PRTR parashtron kërkesat ligjore për raportimet mbi shkarkimet industriale. Në 2019, kërkesat E-PRTR u përditësuan nga Komisioni i Zbatimit të Vendimeve i BE-së 2019/1741, ndërkohë që Rregullorja E-PRTR u përditësua dhe ndryshua në prill 2024, duke krijuar një lidhje më të fortë me Direktivën për Shkarkimet Industriale.

Sipas saj, PRTR synon të ndihmojë në:

1. përmirësimin e të dhënave dhe vënien në dispozicion të publikut të informacionit mjedisor për shkarkimet në mjedis
2. zbatimin rigoroz të standarteve dhe kufijve të shkarkimeve të parashikuara në ligjet e cdo vendi dhe direktivat kuadër, si psh. Direktiva IED
3. përmirësimin e aftësisë reaguese dhe gjurmuese në rastet e aktiviteteve me shkarkime të larta në mjedis
4. marrjen e informacionit të saktë mbi përdorimin e energjisë, ujit, dhe materialeve bazë nga burimet natyrore.

Faqja përkatëse online e Bashkimit Evropian (<https://industry.eea.europa.eu/explore/explore-data-map/map>) tregon se të dhënat e RSHTN për Shqipërinë nuk janë ende të akredituara për tu pasqyruar në databazën e E-PRTR, çka qartësisht lidhet me standartet dhe besueshmërinë e ulët të raporteve të vet-monitorimit nga ku burojnë këto të dhëna, kombinuar me faktin që Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kapacitete të pamjaftueshme për të kryer monitorime dhe inspektime nga laboratorët e saj.

### 5.1 Roli dhe pjesëmarrja e shoqërisë civile në vendimmarrjen dhe monitorimin mjedisor

Në rastin e aktiviteteve me shkarkime në ajër, transferimit të ndotjes apo zhvillimit të planeve dhe strategjive për menaxhimin e ndotjes, **RSHTN do të ishte një instrument themelor tek i cili do të referohej edhe ndertohej argumenti në funksion të mbrojtjes së mejdisit dhe shendetit publik nga ndotja.** Pikërisht aksesin në informacionet publike në lidhje me sasinë e shkarkimeve nga aktivitetet pjesë e RSHTN mund të përdoren nga OSHC-të, ekspertët të fushës apo edhe përfaqësues të komuniteteve për të influencuar një vendimmarrje sa më të drejtë dhe të bazuar në fakte.

Gjithashtu strukturat administrative në nivel komuniteti dhe bashkie, mund të organizojnë një dëgjese publike për të adresuar çështje që lidhen me mjedisin. Në këtë rast RSHTN do të shërbente jo vetëm si një instrument për raportim dhe publikim të dhënash, por edhe një **mjet kontrolli tek i cili OSC, komunitetet dhe autoritetet lokale të gjurmojnë, menaxhojnë dhe minimzojnë ekspozimin ndaj ndotjes.**

Burimi: <https://konsultimipublik.gov.al>

Ndërkohë VKM nr. 247 datë 30/04/2014 "Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore" saktëson procedurat organizative dhe detyrimet e palëve në organizimin

e konsultimeve publike, të cilat janë parakusht për pajisjen me leje mjedisore të subjekteve apo operatorëve me ndikim në mjedis.

Në disa raste RSHTN mund të shërbejë edhe si referencë ligjore për të kërkuar të drejtën sa i takon ekspozimit tej normave të lejuara. E drejta për informim dhe pjesëmarrje në aktivitetet të cilat kanë ndikim në mjedis rregullohet duke ju referuar Ligjit nr. 10431 (ndryshuar) Kreu 2, Neni 13 parashikohet pjesëmarrja e palëve të interesit (konform edhe Ligjit nr. 14/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" si edhe Ligji Nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" gjatë proceseve vendimmarrëse apo hartimit të strategjive, programeve e rregulloreve në funksion të mbrojtjes dhe menaxhimit mjedisor.

Në përmbledhje, shoqëria civile është një aktor kyç në proceset e konsultimit publik, duke siguruar që zëri i qytetarëve të dëgjohet dhe të merret parasysh në vendimmarrje, duke promovuar transparencën, llogaridhënien dhe pjesëmarrjen aktive të komuniteteve në çështjet që i prekin. Në rastin konkret, praktika e konsultimeve publike nga ana e Ministrisë përgjegjëse për Mjedisin dhe organeve të saj si Agjencia Kombëtare Mjedisit, i kryen njoftimet dhe konsultimet kryesisht në formën online nëpërmjet Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet Publike.




Figura 7: Pamja e faqes së internetit për njoftimet dhe konsultimet publike

Në këtë platformë, e cila lehtëson procedurën e ndërveprimit midis palëve, prezantimi i saj në proceset konsultuese edhe pse nuk ka nxitur besueshmëri apo pjesëmarrje më të lartë të aktorëve të shoqërisë civile, mbetet një instrument, i cili duhet shfrytëzuar me vëmendje nga aktorët e OSHC-ve të cilët synojnë përmirësimin e politikave.

Ndërkohë që Agjencia Kombëtare e Mjedisit nëpërmjet drejtorive të saj rajonale i organizon konsultimet publike në formë fizike duke i njoftuar më herët si në portalin e saj zyrtar ashtu edhe në mjediset fizike në afërsi të instalimit/aktivitetit që kërkon të pajiset me leje mjedisore.

Së fundi komisioneri për transparencën në Shqipëri mund të ndërmjetësojë në rastet kur kërkesa për informim apo ankimimet nga qytetarë dhe OSHC nuk adresohen. Praktikisht AKM pranon ankesa nëpërmjet portalit [e-Albania](#) duke plotësuar formularin tip që pasqyrohet në sistem sikundërse edhe duke siguruar prova në formën e fotove, regjistrime, matje e monitorime. Nga ana tjetër fatkeqësisht, koha e reagimit nga ana e AKM-së ndaj ankesave për të adresuar në flagrancë një ndotje është e pamundur si pasojë e mungesës së kapaciteteve njerzore dhe teknike. Kjo situatë sjell më tutje edhe pamundësinë e Policisë së Shtetit apo asaj

Bashkiake për të ndërhyrë, kjo pasi kushtet e lejes mjedisore nuk mund të verifikohen pa matje nëse po shkelen apo jo.

Edhe pse në shumicën e rasteve kontributi dhe komentet nga ana OSHC-ve nuk reflektohen apo te ndikojnë realisht në vendimmarrje, gjë e cila ka sjellë edhe reduktim drastik të pjesëmarrjes nga ana OSHC-ve në këto procese, është tejet e rëndësishme që të vijojë kontributi edhe pjesëmarrja meqë minimalisht shqetësimet e tyre zbardhen në shënimet e këtyre takimeve të cilat më pas mund të ndiqen si argument edhe në rrugë ligjore.

OSHC-të po forcohen dhe maturohen gjithnjë e më tepër përballë një mungese të theksuar kapacitetesh nga autoritetet publike, duke u kthyer në denoncues ndaj krimit mjedisor, i cili në mungesë të inspektimeve nga autoritetet njih një rritje të shprehur pas reformës territoriale të vitit 2014. Gjithashtu vërehet shtimi i pranisë, pjesëmarrjes dhe kontributit të OSHCve në procese të konsultimit publik sidomos në rastet e lidhura me zbatimin e të drejtës për informin kur, nëpërmjet RSHTN, bëhen transparente të dhënat e shkarkimit dhe transferimit të ndotjes për subjektet në Republikën e Shqipërisë.

Është e nevojshme të përfordhet llogaridhënia përmes presionit pozitiv ndaj institucioneve publike, në mënyrë që raportimet në RSHTN t'i vijjnë më pranë realitetit.

Ka së paku dy arsye kryesore përse lind kjo nevojë:

- së pari, në mbi 89% të rasteve të shqyrtuara, të dhënat e gjeneruara nga AKM dhe MTM lidhur me shkarkimet në ajër nuk e pasqyrojnë realitetin.
- së dyti, diçka e tillë mbështetet nga raportimet në terren të shoqatave lokale të cilat ndërmarrin nisma monitoruese, reportazhet mediatike, si dhe paditë penale me objekt gjykimi çështjet mjedisore, ku vetëm në vitin 2023 janë ngritur 25 të tilla.

## 5.2 Konventa e Aarhus-it dhe e drejta për informim

Konventa e UNECE (Komisioni Ekonomik për Evropën i OKB-së), për të Drejtën e Informacionit, Pjesëmarrjes Publike në Vendimmarrje, dhe Qasjes në Drejtësi në Çështje Mjedisore, u miratua më 25 qershor 1998 në qytetin danez të Aarhusit (Århus), nga mori dhe emrin "Konventa e Aarhusit", dhe ku u nënshkrua edhe nga Shqipëria. Parlamenti shqiptar e ratifikoi konventën më 26 tetor 2000, e cila hyri në fuqi më 30 tetor 2001.

Konventa e Aarhus, referuar paragrafit në Nenit 5.9 parashikon detyrimin që palët nënshkruese të krijojnë RSHTN. Ishin Organizatat e Shoqërisë Civile, që kërkuan futjen e këtij parashikimi dhe zbatimin e tij, meqë e shihnin RSHTN si një mjet efektiv në funksion të transparencës ndaj publikut. Më pas, Protokollin për RSHTN në kuadër të Konventës së Aarhusit u negociua dhe u miratua më 21 maj 2004 në Konferencën Ministrore 'Mjedisi për Evropën' në Kiev, Ukrainë, dhe hyri në fuqi më 8 tetor 2009.

**Kjo konventë dhe Protokollin i RSHTN sigurojnë mundësinë për publikun dhe shoqërinë civile për të pasur qasje në informacion mbi shkarkimet dhe transferimet e ndotjes. Ato mund të shërbejnë edhe si argument juridik për trajtimin nga strukturat e drejtësisë nëse kërkesa për informacion apo e drejta për pjesëmarrje *"është injoruar, refuzuar padrejtësisht, qoftë pjesërisht apo plotësisht, nuk është përgjigjur në mënyrë të përshtatshme, ose është trajtuar në mënyrë të papërshtatshme"*.**

Gjithashtu, publiku dhe OSHC-të kanë të drejtën të depozitojnë komunikimi dhe ankesa në Komitetin e Përputhshmërisë së Protokollit, nëse vendi pale në këtë Konventë apo Protokoll nuk i zbaton detyrimet. Të gjitha këto instrumente mund të përdoren lehtësisht nga OSHC-të duke iu dhënë mundësinë që ta trajtojnë çështjen e ndotjes nga niveli vendor, kombëtar e më tej në nivel ndërkombëtar. Për më tepër detaje [UNECE](#)

Konventa është një dokument juridik ndërkombëtar që parashikon një sërë të drejtash për publikun dhe detyrime për autoritetet shtetërore.

Konventa përmban tre shtylla themelore:

- E drejta e publikut për të patur e për të kërkuar informacion mjedisor;
- E drejta e publikut për të marrë pjesë në vendimmarrjet publike për çështje të mjedisit;
- E drejta e publikut për t'u ankuar në gjykatë për çështje të mjedisit.


Qendrat e Informacionit Aarhus u krijuan në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit midis Ministrisë së Mjedisit dhe zyrës së OSBE-së në Shqipëri, "Mbi Bashkëpunimin në fushën e Informacionit Mjedisor dhe Zbatimin e Konventës së Aarhusit në Shqipëri" të nënshkruar në korrik 2006. Ato kishin strukturën e organizata të shoqërisë civile, por me burime njerëzore të kufizuara edhe të varura nga fondet e donatorëve. Për rrjedhojë edhe përgjegjësia dhe ndikimi i tyre për të adresuar tre shtyllat e lartpërmendura mbeti i kufizuar. Gjatë periudhës 2017-2020 Qendra Aarhus Shkodër ka qenë përfshirë në monitorimin e ndotjes urbane në qytetin e Shkodrës.

Në mungesë të kapaciteteve njerëzore dhe teknike nga ana e autoriteteve publike lidhur me kërkesat për informacion dhe ankesat që burojnë nga qytetarë apo organizata, numri i rasteve derguar në gjykatat administrative është rritur konsiderueshëm vitet e fundit. Qendra të ndryshme të këshillimit ligjor po mbështesin gjithnjë e më tepër komunitetet dhe kauzat e organizatave duke vënë në dukje shkeljet në zbatim të ligjeve dhe akteve që sigurojnë pikërisht zbatimin e Konventës së Aarhus në Shqipëri. Në jo pak raste, ankesat apo kërkesat për informacion zvarriten me qëllim tejzgjatjen e proceseve derisa operatori i konstatuar në shkelje të favorizohet për përfundimin e punimeve. Ka pasur edhe raste kur denoncues të shkarkimeve ndotëse, të depozituara në AKM dhe IKMT, u është zbuluar identiteti tek operatorët për të cilët është bërë ankesa, duke kompromentuar procesin.

Nga ana tjetër, në mungesë të Inspektoriatit Mjedisor, Policia e Shtetit nuk merr përsipër konstatim të kushteve të lejes mjedisore lidhur me shkarkimet e ndotjes në ajër, ujë dhe tokë meqë nuk disponon një metodologji dhe kapacitete teknike e njerëzore për të verifikuar veprën e shkaktuar (ndotjen). E njëjta gjë vlen edhe për Policinë Bashkiake, e cila në raste ankesash apo denoncimesh i referohet lejes së nxjerrë nga ky institucion për punime specifike, por i njëjti institucion nuk ushtron të drejtën e kontrollit mbi zbatimin e standardeve të lejeve të dhëna.

### 5.3 Kuadri ligjor shqiptar për të drejtën e informimit

Bazuar në Nenin 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" detyron Autoritetin Publik (në këtë rast AKM) të publikojë Programin e Transparencës të miratuar më herët nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



**Figura 8:** Pamja e faqes së internetit për programin e transparencës (Burimi: <https://akm.gov.al/programi-transparencës-2/>)

Në programin e transparencës pranë AKM gjenden të gjithë instrumentet dhe kanalet e nevojshme për të lehtësuar kërkesën dhe marrjen e informacionit në lidhje me mjedisin në Shqipëri. Për më tepër VKM Nr. 419 "Për Informimin dhe Pjesëmarrjen e Publikut në Lejet Mjedisore të tipit A dhe B, sikundërse edhe Ligji Për Planifikimin e Territorit parashikon konsultimet me publikun lidhur me Vlerësimin Strategjik Mjedisor.

Në të gjithë Europën (përfshirë edhe vendet candidate si Serbia, Bosnia dhe Herzegovina) ka mbi 35,000 operatorë industrialë, të cilët raportojnë dhe publikojnë të dhënat e tyre në këtë platformë.

Ndërkohë që nga Shqipëria është vetëm një numër i kufizuar (4 subjekte industriale) raportojnë dhe publikojnë të dhënat mbi shkarkimet në mjedis në RRSHTN.

#### 5.4. Ndhimesa e RSHTN për informimin dhe pjesëmarrjen mjedisore

Në parim RSHTN kontribon në transparencën dhe pjesëmarrjen më efektive të publikut në vendimmarrjen mjedisore, pasi përmes internetit, në kohë reale publiku mund të ketë qasje në informacionin mjedisor për objektet të cilat shkarkojnë ndotje në mjedis. Publiku mund të marrë informacion për vendndodhjen dhe adresën e subjektit, aktivitetet e kryera, aktivitetet ekonomike, llojin e shkarkimeve, sasi të tyre, etj. Në realitet, RSHTN pasqyron sërish standardin e ulët dhe mangësitë e theksuara në inspektimin mjedisor, sikundëse edhe besueshmërinë e ulët të raporteve të vetmonitorimit në vendin tonë.

Shumë OSHC ngrenë shqetësimin se informacione të rëndësishme lidhur me shkarkimet në ajër, tokë apo ujë të impjanteve industriale si ato të prodhimit të cimentos, metalurgjisë, minierave, përpunimit të mbetjeve, prodhimit të energjisë, etj. nuk gjenden të pasqyruara në këtë regjistër e në shumicën e rasteve nuk pasqyrohen as në Raportin Vjetor të Gjendjes në Mjedisit. Kësisoj qytetarët apo edhe organizatat të cilat mund të kërkojnë të drejtën e tyre ndërkohë që clirohen gazra të pakontrolluara nga këto aktivitete si në rastin e djegieve të mbeturinave (14 raste të raportuara në 2 vitet e fundit) e kanë të pamundur qoftë të kërkojnë dëmshpërblim apo të marrin informacion lidhur me nivelet e ekspozimit.

Monitorimi i mjedisit është një sistem, i cili nëpërmjet paraqitjes dhe analizimit të indikatorëve mjedisorë, që vlerëson kushtet mjedisore, ndotjen nga aktivitetet e subjekteve operuese dhe studion performancën apo produktivitetin e ekosistemeve. Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit përfshin treguesit për analizën e mostrave të ajrit, zhurmës, tokës, ujërave sipërfaqësorë e nëntokësorë, sipërfaqet pyjore dhe biodiversitetin. Bazuar në VKM-në nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", Agjencia Kombëtare e Mjedisit harton çdo vit Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit. Monitorimi mjedisor bazohet në zbatimin e metodologjisë DSPIR (Laura Maxim, 2009) në përputhje më praktikën e Agjencisë Europiane të Mjedisit. Të dhënat e monitorimit pas përpunimit, paraqiten në Raportin e Gjendjes së Mjedisit të vitit respektiv.



## 6. Advokimi mjedisor kundër ndotjes dhe veprimi komunitar

Koncepti i ndotjes urbane në Shqipëri lidhet qartësisht me shkarkimin e substancave të dëmshme, të cilat, në mënyrë natyrale dhe jonatyrale, futen dhe qëndrojnë në qytete dhe në zonat urbane. Emetime që lidhen me aktivitetet njerëzore si ndërtimi, transporti, banimi, industria etj., cilësohen si ndotësit më të mëdhenj në këto zona urbane; kjo për shkak të përqendrimit të lartë të njerëzve dhe aktiviteteve në qendrat urbane. Ndikimi që kanë këta lloj ndotësish, sjellin sfida në nivel global e si rrjedhojë politikat parandaluese apo zbutëse duhet të zbatohen në nivele lokale. Në këtë kontekst, RSHTN ka pjesërisht lidhje me konceptin e ndotjes pasiqë RSHTN trajton kryesisht emetimet që vijnë nga burime pikësore (industri, bujqësi etj), por gjithashtu kërkon raportim në mënyrë progresive nga burimet jo-pikësore (transporti, ndërtimi, aktivitete urbane, SME etj). Informacioni mbi ndotjen në Shqipëri ka dy burimet: industrinë dhe aktivitetet e mëdha të cilat vet-monitrojnë dhe raportojnë tek AKM, si edhe AKM kryen matje monitoruese për ndotjen urbane për të publikuar më pas analizën mbi peshën specifike që ka secili nga këto burime mbi popullatën e ekspozuar.

Raportet lokale dhe ato kombëtare specifikisht kapitujt që mbulojnë ndotjen dhe RSHTN mungojnë në Shqipëri prej më tepër se 7 vitesh. **Përgjegjës për informimin e publikut në raport me cilësinë e ajrit, nivelin e shkarkimeve në ajër janë Agjencia Kombëtare e Mjedisit si edhe Instituti i Shëndetit Publik.** Në anën tjetër raportet ndërkombëtare e rendisin Shqipërinë si një nga vendet me ekspozimin më të lartë të popullatës përkundrejt ndotësve. Në rast se vendet e rajonit kanë ndotje sezonale në qytetet Shqiptare përqendrimi i ndotësve mbetet konstant përgjatë gjithë vitit. Madje, së fundmi, Agjencia Evropiane e Mjedisit citon se ndikimet në shëndetin publik të lidhura me ndotjen e ajrit, sjellin një reduktim me rreth 184 ditë nga jeta e personave të ekspozuar dhe rreth 3,500 vdekje të parakohshme në vit si pasojë e cilësisë së ulët të mjedisit. Kjo mangësi në raportimin e ndotjes dhe shkarkimeve vjen si pasojë e mungesës së kapaciteteve njerëzore dhe teknike për të përmbushur detyrimet ligjore në lidhje me monitorimin dhe raportimin e ndotjes.

Konkretisht, në vendin tonë, ndotja është tërësisht e menaxhueshme dhe për fat të keq plotësisht e shmangshme, për sa kohë mbetet ngushtësisht e lidhur me trafikun e rënduar, mungesën e hapësirave të gjelbra, ndërtimet, karburante me cilësi të dobët dhe kryesisht nga moszbatimi dhe inspektimi i detyrimeve ligjore për parandalimin e shkarkimeve në mjedis. Raporti Gjendjes së Mjedisit, detyrë funksionale e AKM dhe Raporti mbi Shëndetin Urban, të cilat duhet të përmbajnë informacion lidhur me nivelet e matura të ndotjes në vend janë raporte që publikohen çdo vit. Nga ana tjetër autoritetet janë të detyruara të bëjnë publike raportet vjetore të RSHTN, të dorëzojnë mbi bazë vullnetare raportet e ndotjes dhe shkarkimeve pranë Agjencisë Evropiane të Mjedisit.

Çdo 4 vjet, palët nënshkruese të protokollit RSHTN duhet të dorëzojnë një raport në Sekretariatit e Protokollit PRTR të UNECE për zbatimin e RSHTN. Më herët raporti paraprak, përpara dorëzimit duhet të bëhet i disponueshëm për konsultime publike gjë e cila nuk ka ndodhur ende në Shqipëri. Në këtë drejtim vetë përgatitja e këtij raporti është gjithashtu një mundësi për Shoqërinë Civile që të shprehë mendimet e saj mbi zbatimin e Protokollit, si funksionon RSHTN në vend, çfarë mungon, të bëjë propozime për përmirësimin e tij, etj.

Në një kohë kur mbrojtja e mjedisit jo vetëm nuk po merr fondet, mjetet dhe vëmendjen e duhur Shoqëria Civile me fokus mjedisin ka arritur të faktorizojë çështje me rëndësi komunitare apo edhe kombëtare vitet e fundit duke u kthyer në të vetmen pararojë karshi favorizimit të theksuar që qeveritë vendore dhe qendrore kanë përballë zhvillimit ekonomik dhe infrastrukturor.

## 6.1. SHEMBUJ TË FUSHATAVE ADVOKUESE TË SHOQËRISË

### REC Shqipëri promovon RSHTN tek OSHC

Mushkëri të Gjelbra Gjatë periudhës 2022–2024, projekti "*Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Western Balkan Countries and the Republic of Moldova*", Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri (REC Albania) ka organizuar një sërë aktivitete për të njohur organizatat e shoqërisë civile aktive për çështjet mjedisore në Shqipëri me mundësinë e përdorimit të informacionit në RSHTN lidhur me ndotjen sipas rajoneve ku ndodhen. Këto aktivite kanë përfshirë trajnime tematike mbi mënyrën e grumbullimit të të dhënave, procedurën e raportimit prej operatorëve, mundësinë e aksesit për të dhënat. Shkëmbimi i përvojës me organizata aktive në rajon mundësoi njohjen e rasteve konkrete ku të dhënat prej RSHTN kanë ndihmuar në organisimin e fushatave të advokimit dhe veprimet konkrete me komunitetin.

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile në forumet e aktorëve, së bashku me institucionet përgjegjëse për RSHTN dhe operatorët industrialë ndihmoi në një vendosjen e lidhjeve të drejtpërdrejta të komunikimit dhe bashkëpunimit për të ardhmen.



Dialogu i vazhdueshëm dhe komunikimi efektiv janë mjete që sigurojnë bashkëpunimin për të mirën e përbashkët: mjedis cilësor për komunitetin!

*(Burimi: [www.recshqiperi.org](http://www.recshqiperi.org))*




### **Mushkëri të Gjelbra**

Një platformë alternative, e cila informon lidhur me çështjen e cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmave dhe shërbimet e ekosistemit të gjelbërimit urban në 5 qytetet kryesore të Shqipërisë (Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë, Shkodër). Raportet vjetore mbi këto komponent si edhe ndërfaqja për të aksesuar monitorimet në nivel lagjeje e kanë kthyer këtë platformë në të vetmen burim informacioni për ajrin, zhurmën dhe gjelbërimin. Ideuar dhe themeluar 7 vite më pare nga Rodion Gjoka gjatë kohës që drejtonte njësinë e mjedisit pranë Co-PLAN. Kjo platformë vijon të hedh dritë mbi cilësinë e mjedisit urban. Më mbi 300 referime të ndryshme në median e shkruar, visive dhe botime shkencore. Mushkëri të Gjelbra ka faktorizuar çështjen e cilësisë së ajrit në vëmendjen e qytetarëve dhe politikës në vend.

Projekti fillimisht u financua nga Delegacioni i BE-së në Shqipëri (2017 – 2021) dhe më tej me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) (2022 –

2027). Gjithashtu, ka një numër të madh aktorësh të përfshirë në këtë nismë, si Milieukontakt Albania, Qendra EPER, GO2 Shkodra, Qendra Aarhus Shkodra, Eko-Mjedisi Durrës, Klubi Ekologjik Elbasan, dhe më tej katër universitete në Shqipëri, Universiteti Polis, Universiteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Durrësit dhe Universiteti Bujqësor i Tiranës. "Mushkëritë e Gjelbra" monitoron tetë ndotës të ndryshëm në bashkitë e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Korçës dhe Shkodrës, specifikisht PM10, PM2.5, CO, CO2, SO2, NO2, C6H6 dhe VOC, si edhe zhurmat urbane e gjelbërimin urban. Nisma i ndan gjetjet e saj përmes një platforme online, duke mbuluar 2,340 aktivitete monitorimi. *(Burimi: Co-PLAN)*

Raportet vjetore mbi ndotjen e ajrit, zhurmat dhe vlerësimin e shërbimeve të ekosistemit nga gjelbërimi urban publikohen që nga viti 2018. Më shumë se 200 artikuj mediatikë, mbi 20 referime në tezatat doktorale, Master e Bachelor, e mbi 140 citime në publikime shkencore ndërkombëtare e kanë faktorizuar këtë platformë dhe praktikë si një pikë referimi dhe shembulli mbi monitorimin e mjedisit. Studime tematike të dedikuara për transportin, ndërtimin, gjelbërimin urban, ndikimin e Covid-19, ndotjen në institucionet e arsimit dhe ekspozimin e popullatës ndaj ndotjes, kanë kanalizuar interesin publik për ndotjen e ajrit deri sa ajo u bë një nga temat kryesore gjatë zgjedhjeve vendore të vitit 2023 në Shqipëri.



**Figura 9:** Hartë e monitorimit të cilësisë së ajrit në qytetin e Tiranës prej të dhënave të monitorimit

Qëllimi i monitorimit alternativ të ndotjes në mjedis nga organizatat e shoqërisë civile apo edhe nga zbatimi i konceptit të “shkencës së qytetarëve” është të adresojë në mënyrë indikative dhe edhe sasiore ndotjen e ajrit, nivelin e zhurmave në zonat urbane si edhe reduktimin e gjelbërimit urban. Kjo nuk përfshin në asnjë rast përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe metodologjive shkencore pjesë e ligjeve mbi monitorimin e mjedist. Të dhënat e monitorimit alternativ mund të konsiderohen plotësuese në kuadër të gjurmimit dhe interpertimit të faktorëve ndotës në zonat urbane për të ndikuar në procese të ndërgjegjësimit dhe vendimmarrjes.



### “ERZENI THËRRET” DHE “ACTIVE WATER”

Këto dy NISMA janë zbatuar nga North Green Association dhe H2H Foundation. Objektiv i këtyre projekteve ka qenë monitorimi ajror (dron) dhe matje laboratorike të cilësisë së ujit dhe tokës në basenin Ishëm-Erzen për të verifikuar ngarkesën ndotëse që shkarkohet nga biznese dhe industritë mbi sipërfaqen ujore. Rezultatet laboratorike tregojnë praninë shqetësuese të disa ndotësve, gjurmë të të cilave gjenden edhe në nën-produktet bujqësore të zonën që përdorin ujrën e këtij baseni. Publikimet dhe raportet shoqëruese janë prezantuar në forumet kombëtare që organizoi Green-AL sikundër edhe janë pjesë e deklaratave të cilat u janë dërguar autoriteteve përgjegjëse, të cilat ende pas dy vitesh nuk reagojnë mbi situatën.

H2H Foundation thekson se ndotja e trupave ujor që përdoren për ujitje, sjell pasoja të rënda në shëndetin e fermerëve të cilët merren me ujitjen e tokave bujqësore si edhe pasoja në shëndetin e konsumatorit fundor, ndotje të tokës si edhe rënie të produktivitetit të kulturave si rrjedhojë e grumbullimit në sasi të konsiderueshme të ndotësve të ndryshëm. Nëpërmjet kryerjes së kampionimeve në tre periudha të ndryshme të përdorimit dhe aksesit ndaj ujit për ujitje në kanalin ujitës Bërzhit-Petrelë-Vaqarr, i cili ndodhet në krah të lumit Erzen, është arritur në përfundimin se



në kanal in kryesor ujitës parametrat biologjike si nevoja biokimike për oksigjen, *E. coli*, Total coliforms, Intestinal eterococci, kanë rezultuar mbi normat e lejuara të përcaktuara nga Direktiva Kuadër e Ujit nga Bashkimi Evropian si pasojë e shkarkimeve urbane të pamenaxhuara në këtë kanal.

NATYRË DHE MJEDIS | SHQIPËRI

## Shqipëri: Të thithësh vdekjen! Ekonomi ndërtuar mbi ndotjen

31/01/2024

Tirana dhe Elbasani kryesojnë listën e qyteteve më të ndotur të Shqipërisë. Burimi kryesor i ndotjes së ajrit janë sektori i ndërtimit, automjetet e vjetëruara dhe industria e rëndë.



Tirana dhe Elbasani kryesojnë listën e qyteteve më të ndotur të Shqipërisë

Fotografi: Kristi Çavo

### FANI I MADH NËN MBROJTJEN E KOMUNITETIT

Kjo nismë është zbatuar në Bashkinë Fushë-Arrëz dhe Pukë përkatësisht në basenin e lumit Fan i Madh në afërsi të minierës dhe industrisë së Bakrit në atë zonë. Nisma kreu monitorime specifike të metaleve të rënda në lumin Fan i Madh në disa pika strategjike para edhe pas vendndodhjes së industrisë së Bakrit duke gjurmuar kështu ndotje dhe shkarkime të patrajuara direkt mbi trupat ujorë.

### NDOTJA NË PATOS-MARINËZ

Nisma advokuese u zbatua në zonën naftënxjerrëse të Patos-Marinëz, e njohur historikisht për ndotjen e lartë me të cilën banorët e zonës bashkëjetojnë prej vitesh. Konkretisht, të dhënat laboratorike nga organizata Eco Partners for Sustainable Development, tregojnë se ujërat e analizuara kanë përmbajtje të lartë dhe shumë të lartë të metaleve të rënda, si: Zn >2000 µg/l; Ni >20 µg/l; Cr >100 µg/l; Cu >20 µg/l; Co >50 µg/l; Pb > më shumë se norma vjetore 7.2 µg/l. Vlerat e parametrave të pH NKO,

NBO5, H2S tregojnë se, nafta ka shkaktuar ndryshime të kushteve të sistemeve ujore, duke ndikuar në vazhdimësinë e biotës në zonën nën presionin e ndotjes. Nga raporti vlerësimi social rezulton që ka një mungesë informacioni dhe monitorimi të shëndetit të banorëve që jetojnë në këtë territor, për të vlerësuar se si ndikon situata e mjedisit direkt në cilësinë e shëndetit të tyre.

## Rast studimor nga rajoni

Qyteti industrial i Zenicës, në Bosnje dhe Hercegovinë, përballet me nivele të larta të ndotjes së arjit si pasojë e veprimtarisë së uzinës metalurgjike ArcelorMittal. Shoqata lokale "Eko Forum Zenica" u përpoq të mbledhte informacion për cilësinë e ajrit dhe shkarkimet e kompanisë ArcelorMittal për të përcaktuar se nga buronte kjo ndotje. Ata ju drejtuan autoritetit mjedisor me disa kërkesa për informacion lidhur me shkallën e shkarkimeve, vëllimin e prodhimit, si dhe sasinë e sqafurit në qymyr.



Shoqata EFZ analizoi burimet dhe shkaqet reale të ndotjes dhe organizoi një fushatë publike kundër këtij ndotësi. Kompania operonte pa leje mjedisore prej disa vitesh radhazi, edhe pse ishte e detyruar të pajisje me lejet përkatëse deri në fund të vitit 2008. Më tej, shoqata EFZ mori pjesë në dëgjuesat publike lidhur me procedurat e lëshimit të lejeve mjedisore përgjatë vitit 2009, ku paraqiti të dhënat e mbledhura për shkarkimet, si dhe pasqyroi komentet e saj në të gjitha dokumentet për shqyrtim. Pavarësisht këtij presioni, kompania sërisht përfitoi një shtyrje deri në vitin 2011, teksa vazhdoi të shkarkonte tonelata me pluhur dhe kimikate nga uzinat e saj. Ishin nivelet shumë të larta të ndotjes që i detyruan njerëzit të dilnin në demonstrata. Më shumë se dhjetë mijë qytetarë u mbledhën në qendër të qytetit dhe marshuan drejt selisë së ArcelorMittal në dhjetor të vitit 2012. Ata kërkuan që të respektoheshin të njëjtat rregulla të zbatuara

në vendet e Bashkimit Evropian, sikurse dhe kompania kishte premtuar fillimisht.

Në dhjetor të vitit 2014, kur 5 nga 9 lejet mjedisore të ArcelorMittal skadonin, ndërkohë që as Ministria e Mjedisit dhe as Inspektorati i Mjedisit nuk morën masa, "Eko Forum Zenica" dhe komunitetet vendase ngritën kallëzim penal ndaj kompanisë për ndotje mjedisore, si dhe ndaj zyrtarëve, për shpërdorim detyre. Në fund të vitit 2015, Ministria e Mjedisit rinovoi lejen mjedisore vetëm për një impiant, por edhe ajo leje u



kundërshtua në gjykatë, pasi publiku nuk ishte përfshirë në konsultime gjatë procesit të rinovimit. Në fillim të vitit 2016, kur skadonin të gjitha licencat e mbetura, kompania aplikoi për një licencë të re për të gjitha impiantet së bashku. Por kësaj here, Ministria e Mjedisit përfshiu në procedurën e vlerësimit të kërkesës përfaqësues të qytetit dhe të "Eko Forum Zenica". EFZ ngriti edhe çështjen e përgjegjësisë penale të zyrtarëve për mosveprim karshi kompetencave të tyre, ndërsa disa viktimat të prekura nga ndotja ngritën edhe kallëzime penale. Edhe pse ArcelorMittal në Zenicë është larg standardeve të BE-së, përpjekjet e përbashkëta të qytetarëve dhe shoqërisë civile përmes dëgjësive dhe betejave ligjore dhanë rezultat dhe ngjallën shpresën se cilësia e ajrit në Zenicë mund të përmirësohet në të ardhmen. Nismat ligjore mund ta detyrojnë kompaninë e fuqishme të fillojë të kujdeset për ndikimin mjedisor të operacioneve të saj.

Protestat masive bënë të dukshme ndërkombëtarisht ndotjen tragjike në Zenicë. Duke qenë se autoritetet shtetërore kanë qenë neglizhente prej vitesh, banorët vendas ndoqën një sërë strategjish të kombinuara, sikurse ishin paditë e posaçme të individëve të prekur, kallëzimet penale kundër zyrtarëve shtetërorë, si dhe pjesëmarrja në të gjitha dëgjësat publike dhe procedurat vendimmarrëse, për ta adresuar më tej çështjen. Një presion i tillë shoqëror dhe ligjor mund ta detyrojë një kompani kaq të fuqishme të fillojë të kujdeset për ndikimin mjedisor të operacioneve të saj.

Pikërisht, qëllimi kryesor i një RSHTN-je është t'i japë publikut mundësinë për t'u informuar rreth burimeve të ndotjes. OJQ-të duhet të kenë akses në informacione të tilla për të ditur se ku t'i drejtojnë përpjekjet dhe veprimtaritë e tyre, cilat janë burimet kryesore të ndotjes dhe se cila është përbërja e substancave ndotëse.



Kësisoj, shoqata "Eko Forum Zenica" përdori të dhënat e RSHTN-së për disa nga aktivitetet e saj, ndër të cilat:

- Verifikimin e informacionit dhe përcaktimin e masave të reja për lëshimin e lejeve mjedisore;
- Ndihmën për qeverinë që të planifikojë dhe veprojë ndaj ndotësve;
- Krijimin e një regjistri alternative, të bazuar në të dhënat e nxjerra nga autoritetet përmes kërkesave për informacion drejtuar këtyre të fundit: <https://eko.ba/baza-zagadivaca>
- Zbulimin e pikave më të nxehta dhe paraqitjen e tyre përmes një harte interaktive: <https://eko.ba/hotspots>
- Publikimin e të dhënave lidhur me dhjetë ndotësit kryesorë në vend;
- Gjurimin e të metave në raportimin e bërë nga operatorët, si dhe të të dhënave që mungojnë.

Burimi: <https://eko.ba/hotspots/42-zeljezara-arcelor-mittal>; prezantime të z. Samir Lemeš, Eko Forum Zenica, në takimet dhe trajnimet e organizuara në kuadër të projektit "Enhancement of Pollutant Release and Transfer Registers (PRTRs) in the Western Balkan countries and the Republic of Moldova".



## 7. Burimet e informacionit

LIGJI NR. 06 L-081: Për qasje në dokumente publike

LIGJI NR. 08 L-145: Për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes

LIGJI NR. 03 L-025" Për mbrojtjen e mjedisit

Broshurë për Qasje në Dokumente Zyrtare

Forum (2015): Një Përrallë Moderne, Kosova C 2100MW

GAP (2017): Roli dhe Rëndësia e Qytetarisë Aktive

GIZ (2013): Përmbledhje legjislacioni për të drejtën e qasjes në dokumente publike,

KEC (2019): Pjesëmarrja dhe ndikimi i organizatave të shoqërisë civile në proceset e politikë-bërjes dhe vendimmarrjes në Kosovë

REC (2006): Konventa "Aarhus" Kuptimi, rëndësia dhe aspekte të zbatimit të saj në praktikë,

Secretariat of the Aarhus Convention, UNECE: Note on Civil Society Space

<https://www.balkangreenfoundation.org/en-us/publications/>

<https://www.kosid.eu.com/>

<https://indep.info/publikimet-2/>

<https://uca.ldipeja.org/>

<https://birn.eu.com/news-and-events/green-energy-days-2022-comes-to-an-end/>

<https://kigngo.com/>



transfer